



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**VENDIM**  
**Nr. 474, datë 13.10.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**V E N D O S I :**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Artan Hajredinaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për dërgimin e çështjes penale në gjyq me nr.120 viti 2017, për të pandehurin {...} akuzuar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi (relator), Rexhep Karaj dhe Suela Lika, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasja për shkak të rrethanave familjare”, parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal”

## **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj dhe Valbona Vata, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar neni 83/1 i Kodit Penal”.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Edlira Petri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Elbana Lluri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha (relatore), Elona Toro dhe Genti Shala, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”.

## **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 130/a i Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 141/a/1 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Florjan Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Neni 76-22 i Kodit Penal”.

## **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Pezullim i ekzekutimit të vendimit nr.333, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Rishikimin e vendimit nr.333, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Prishjen tërësisht të vendimit nr.333, datë 17.12.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vazhdimin e gjykimit të çështjes në themel”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen civile me Paditës {...}; Të paditur: {...}; Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr.4952 rep, 254 kol., datë 30.08.2004; Detyrim për njohje pronar të shtetit shqiptar, etj.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

### **KRYETARE**

**NAUREDA LLAGAMI**

Spektori i Organizimit të Mbledhjeve: Krisulla Kasaj  
Drejtoria juridike: Vildan Kaloshi  
Departamenti i Shërbimeve Juridike: Maela Alicanaj  
Sekretar i Pergjithshem: Rudin Baqli  
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: Ilir Toska